



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT
KËSHILLI I GJYKATËS

Nr. 26 Prot

Tiranë, më 18.01.2023

V E N D I M

Nr. 45, datë 18.01.2023

“PËR EMËRIMIN E SHTETASIT ROMEO SHEHU SI NËPUNËS CIVIL
GJYQËSOR, SEKRETAR GJYQËSOR”

Këshilli i Gjykatës Administrative të Apelit, i përbërë nga:

Enkelejda METALIAJ (SOFTA)

Zëvendëskryetare e Gjykatës,

Blerona HASA

Anëtare Zëvendësuese,

Leonard STRATAJ

Kancelar i Gjykatës,

Asistuar nga sekretarja **Kristina PËRNASKA**, i mbledhur në Tiranë, sot më datë, **18.01.2023**, pasi mori në shqyrtim çështjen e emërimit nëpërmjet lëvizjes paralele, si nëpunës civil gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit, të sekretarit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Romeo Shehu,

V Ë R E N

Se Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 622, datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” ka miratuar procedurën për plotësimin e vendeve vakante në shërbimin civil gjyqësor.

Nga ana e Gjykatës është njoftuar Këshilli i Lartë Gjyqësor se pranë këtij institucioni janë 2 (dy) vende vakante në shërbimin civil gjyqësor, kategoria ekzekutive “Sekretar gjyqësor”.

Në ligjin nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe Vendimin nr. 622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor

parashikohet se vendet vakante në shërbimin civil gjyqësor plotësohen me rikthimin në zbatim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, rikthimin, për shkak të pezullimit, nëpërmjet transferimit sipas neneve 66, 67 dhe 68 të ligjit nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në rast të pamundësisë për plotësimin si më sipër, atëherë në radhë zbatohet lëvizja paralele, ngritja në detyrë dhe në fund pranimit në shërbimin civil gjyqësor.

Në këto kushte në mbledhjen e datës 19.12.2022, Këshilli i Gjykatës vendosi të procedojë për plotësimin e vendeve vakante me anë të lëvizjes paralele dhe shpalli njoftimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Gjykatës, si dhe gjithë gjykatave të vendit me kushtet e kërkuara. Afati i aplikimit për lëvizjen paralele u caktua deri më datë 04.01.2023. Rezulton se deri në këtë datë është paraqitur aplikimi i shtetasit Romeo Shehu. Në përfundim të verifikimit paraprak të kandidatit Romeo Shehu për përmbushjen e kushteve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele për pozicionin vend vakant “Sekretar Gjyqësor” në Gjykatën Administrative të Apelit, ky e fundit është kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë, atë të vlerësimit profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në këto kushte, Këshilli i Gjykatës është mbledhur në datë 12.01.2023 duke bërë vlerësimin e kandidatit të kualifikuar Romeo Shehu. Ndërkohë u mbajt parasysh fakti që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar edhe Udhëzimin nr. 85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurrimit të hapur”, pra përpara vlerësimit dhe për rrjedhojë Këshilli u bazua edhe mbi këtë vlerësim.

Këshilli i Gjykatës, mori në intervistë kandidatin e kualifikuar Romeo Shehu, duke i drejtuar pyetje rreth përvojës arsimore, profesionale, referuar nenit 11, të Vendimit nr.622, datë 10.10.2020 dhe Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Gjykatës pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga kandidati Romeo Shehu miratoi vlerësimin si më poshtë: Për vlerësimin e përvojës profesionale, anëtari i parë ka dhënë 40 pikë, anëtari i dytë ka dhënë 40 pikë, anëtari i tretë ka dhënë 40 pikë. Për kriterin e vlerësimit në punë, të gjithë anëtarët kanë dhënë 40 pikë. Për pikët në fushën e trajnimeve ose kualifikimeve, të gjithë anëtarët kanë dhënë 0 pikë. Nga mbledhja e vlerësimit të përvojës profesionale, vlerësimit në punë dhe vlerësimit të trajnimeve profesionale, në total kandidati Romeo Shehu u vlerësua në total me 80 pikë. Sipas nenit 11, të Vendimit nr.622/10.12.2020

“Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” kandidati Romeo Shehu konsiderohet i suksesshëm.

Neni 13, pika 1, e Vendimit nr.622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor parashikon se: “1.Këshilli, brenda 24 (njëzet e katër) orëve, pas përfundimit të procedurave të ankimit, bën emërimin e kandidatit me më shumë pikë, nga lista e hartuar sipas pikës 2 të nenit 11 të këtij vendimi”.

Në kushtet kur kandidati Romeo Shehu plotëson kushtet formale për lëvizjen paralele dhe ka marrë 80 pikë në vlerësim, Këshilli i Gjykatës çmon njëzëri se ai duhet të emërohet si “Sekretar Gjyqësor” në Gjykatën Administrative të Apelit, dhe për rrjedhojë:

V E N D O S I:


1. Emërimin e shtetasit z. Romeo Shehu si nëpunës civil gjyqësor “Sekretar Gjyqësor” pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
2. z. Romeo Shehu të bëjë dorëzimet brenda 5 ditëve nga nxjerrja e këtij akti në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
3. Vendimi t’i njoftohet kandidatit, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të gjithë Gjykatave të Republikës së Shqipërisë.
4. Ngarkohet Kryetari i Gjykatës dhe Kryesekretarja për zbatimin e këtij vendimi.

Tiranë, sot më datë 18.01.2023.

Anëtar

Kancelari


Leonard STRATAJ



Anëtare

Anëtari Zëvendësues

Blerona HASA



Kryetare

Zëvendëskryetare

Enkelejda METALIAJ

(SOFTA)

